



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA MALIQ  
KRYETARI

Nr 3910/Prot  
/2

Maliq, më 22.08.2024

**PROJEKT-VENDIM**

**Rishikimi i Vendimit të Këshillit Bashkiak Maliq - NR. 7**  
**Nr 75, datë 12.07.2024**  
**Për**

**“Miratimin e tavaneve përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afat mesëm për periudhën 2025-2027 në nivel programi”**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, neni 8, pika 2, neni 9, pika 1, nënpika 1.1, gërma “b”, “Kompetencat dhe detyrat e Kryetarit të Bashkisë” pika “c”, ligjit nr.68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 6 “Kompetencat e këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore” Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.3, datë 28.02.2024, “Për përgatitjen e programit buxhetor afat mesëm vendor 2025-2027” dhe udhëzimit plotësues të Ministrisë Financave nr.8, datë 05.07.2024, “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2025-2027”, i propozoj Këshillit të Bashkisë,

1. Të rimiratojë tavanet përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm për periudhën 2025-2027 në nivel programi, sipas tabelës shoqëruese.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e të Ardhurave dhe Drejtoria e Financës në Bashki.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar.

Konceptoi :A.Muka

**KRYETARI I BASHKISË**

Gëzim DOPÇIU





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA MALIQ  
Drejtoria e Financës dhe Buxhetit

Maliq më 23.8.2024

Nr: 3810/2

RELACION

Për

**"Miratimin e taveve përfundimtare të Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2025-2027"**

*Të nderuar këshilltarë të Këshillit të Bashkisë Maliq !*

Në mbështetje të ligjit nr.68/2017 "për financat e qeverisjes vendore" neni 6 "Kompetencat e Këshillit të Njësisë së Vetëqeverisjes Vendore, Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë" nr.3, datë 28.02.2024,"Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2025-2027, Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.8, datë 05.07.2024,"Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2025-2027 po i paraqesim këshillit të bashkisë projekt-vendimin lidhur me miratimin e taveve përfundimtare të programit buxhetor afatmesëm 2025-2027.

Pasqyrat që po ju paraqesim përmbajnë të dhënat e përlogaritura nga ana jonë për të gjitha zërat e buxhetit (paga, sigurime shoqërore, shpenzime operative dhe investime) bazuar në kërkesat e ardhura nga programet respektive.

Po të krahasojmë tavanet përgatitore të miratuara nga ana juaj në muajin mars 2024 me vendim nr.28, datë 15.03.2024 me ato të propozuara nga ana jonë për tave përfundimtare, ka ndryshim si më poshtë :

Viti 2025 ndryshim prej 21,820 000/lekë

Viti 2026 ndryshim prej 22,048 000/lekë

Viti 2027 ndryshim prej 22,279 000/lekë

Kjo diferencë vjen si rezultat i ndryshimit nga ana e Ministrisë së Financave për transfertat e pakushtëzuara dhe sektoriale, Këto transfertat u futën në sistemin e ri të PBA-së 2025-2027 dhe u rakorduan me të gjitha njësitë shpenzuese.

Mbi këto tave përfundimtare do të punojnë edhe Drejtuesit e ekipeve të Menaxhimit të Programeve (EMP) deri me 31 gusht 2024, për të bërë të mundur hartimin e një programi sa më realist me qëllim përmbushjen sa më të mirë të shërbimeve ndaj komunitetit.

Në këto kushtë jemi munduar të bëjmë një detajim sa më të saktë të të gjitha zërave të Projekt Buxhetit Afatmesëm 2025-2027, duke ju propozuar për miratim tavanet përfundimtare.

**Drejtori i Financës dhe Buxhetit**

**Almira Muka**

**KRYETARI I BASHKISË**

**Gëzim Topciu**

